

Njoftim për përqendrim me të cilin Gebr. Hajneman SE & Co. KG, Gjermani dhe z. Udo Hojzer, Gjermani do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi TMC Nordik A/S, Danimarkë

(lënda nr. 08-158 /2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe 208/24), më datë 05.12.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët nga Gebr. Hajneman SE & Co. KG me seli të regjistruar në adresën Koreashtrase 3, 20457 Hamburg, Gjermani dhe Z. Udo Hojzer me adresë në Hohenloheplac 6, 65193 Viesbaden, Gjermani mbi TMC Nordik A/S me seli të regjistruar në Transformervej 8, 2860 Soborg, Danimarkë.

Nobilis, një shoqëri nën kontrollin e përbashkët të GH Gebr. Hajneman SE & Co. KG dhe (indirekt) të z. Hojzer, aktive në shitjen me shumicë të parfumeve dhe kozmetikës në rajonin DACH (Gjermani, Austri dhe Zvicër), synon të fitojë 100% të aksioneve dhe kontrollin në Shoqërinë e Synuar, e cila është aktive në shitjen me shumicë të parfumeve dhe kozmetikës në vendet skandinave (Danimarkë, Finlandë, Norvegji dhe Suedi), nga Shitësi në dy hapa:

- Hapi 1: Fitimi i 65% të aksioneve në shkurt 2025 (pasi të marrin të gjitha miratimet për përqendrimin) ("**Hapi 1**");
- Hapi 2: Fitimi i 35% të mbetura të aksioneve në vitin 2028 bazuar në opsionet e blerjes dhe shitjes (call-/put-options) ("**Hapi 2**").

Ndërmjet këtyre dy hapave (zbatimi i Hapit 1 dhe Hapit 2), Nobilis dhe Shitësi do të trajtohen në mënyrë të ngjashme si aksionarë me 50%/50% aksione, përkatësisht do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë e Synuar.

Gebr. Hajneman SE & Co. KG është një biznes familjar me seli në Hamburg që përmes Grupit GH menaxhon dhe furnizon dyqane pa taksa/dyqane për oferta të vlefshme udhëtimi të Grupit GH në aeroporte, porte detare dhe pika kufitare në mbarë botën. Grupi GH menaxhon 350 pika shitjeje gjatë udhëtimit në 73 aeroporte ndërkombëtare bazuar në marrëveshje koncesioni ose qiraje me operatorët e aeroporteve. GH shet produkte me pakicë gjatë udhëtimit për udhëtarët, veçanërisht në kategoritë e parfumeve, kozmetikës, alkoolit, produkteve të duhanit, mishrave të thatë dhe ëmbëlsirave.

Gebr. Hajneman SE & Co. KG ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut, konkretisht shoqërinë **TRAVEL FRI MA SHPKNJP Shkup**, me seli të regjistruar në Rr. "Maqedonia" nr. 5/2-22 Shkup-Qendër, dhe veprimtari prioritare të regjistruar - tregtia me pakicë në dyqane të paspecializuara, kryesisht me ushqime, pije dhe duhan. TRAVEL FRI MA SHPKNJP Shkup ka realizuar të ardhura përmes shitjes me pakicë dhe shitjes me shumicë të mallrave me pakicë gjatë udhëtimit.

Z. Hojzer është ortak i vetëm i fuks4future, një kompani holding që është ortak me kontroll të përbashkët të Nobilis. Për më tepër, ai është drejtor ekzekutiv i Nobilis. Z. Hojzer nuk ka pjesëmarrje në shoqëri që kanë prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe shoqëri që janë nën kontrollin e z. Hojzer [nuk kanë realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023].

Sajdvalk Ran është një shoqëri holding në pronësi të Hajdi Behrens(Heidi Behrens) (drejtore ekzekutive e Shoqërinë së Synuar), Fiona Behrens dhe Frederik Behrens (secili me 33.3%). Sajdvalk Ran nuk ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

TMC Nordik A/S vepron si partner shpërndarës për markat e bukuri në vendet skandinave (Danimarkë, Finlandë, Norvegji dhe Suedi) që ndihmon partnerët e saj me një sërë shërbimesh që përfshijnë zinxhirin e furnizimit, marketingun, shitjet dhe raportimin.

TMC Nordik A/S menaxhon 63 punonjës nga selia kryesore në Kopenhagën, Danimarkë, si dhe nga zyrat e saj lokale të shitjeve në Suedi dhe Norvegji që menaxhohen nga filialet e saj:

- TMC Nordic AB, me seli në Hammarbibaken 27, 120 30 Stokholm, Suedi; dhe
- TMC Nordic AS, me seli në Dronning Eufemias porta 16, 0191 Oslo, Norvegji.

Si tregtar me shumicë i parfumeve dhe kozmetikës, TMC Nordic A/S realizon vetëm shitje ndaj tregtarëve me pakicë (duke përfshirë shitjet në parfumeri, qendra tregtare, farmaci dhe kanale të tregtisë elektronike).

TMC Nordic A/S nuk ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut në vitin 2023.

Tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet si:

- shitja (duke përfshirë shitjen me shumicë) e parfumeve dhe kozmetikës në sektorin (e rregullt) të shitjes me pakicë ku Shoqëria e Synuar (në vendet skandinave) dhe Nobilis (në rajonin DACH) janë aktive, por jo në Maqedoninë e Veriut;
- (ii) blerja e parfumeve dhe kozmetikës në sektorin (e rregullt) të shitjes me pakicë ku Shoqëria e Synuar (në vendet skandinave) dhe Nobilis (në rajonin DACH) janë aktive, por jo në Maqedoninë e Veriut; dhe
- (iii) shërbimet e shitjes me pakicë gjatë udhëtimit (shitja me pakicë gjatë udhëtimit) në vendet e udhëtimit, ku GH është aktive inter alia, në Maqedoninë e Veriut.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim tek Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

16.12.2024

Shkup